


SHPALLJA E MALIT SHARRI SI PARK NACIONAL

# PENSIONISTËT TË KËNAQUR ME SHPALLJEN E SHARRIT - PARK NACIONAL

Nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor paralajmërojnë bisedime me popullatën lokale, me qëllim që të dëgjohet mendimi i tyre. Përndryshe, ky propozim bazon në mendimin e ekipit të ekspertëve pas studimit të përpiluar për valorizim të përmbajtjeve me nivel të lartë të vlerave biologjike dhe kulturore

Alpinistët, dashmirët e ajrit të pastër, të florës dhe faunës endemike, dhuntive të tjera të malit, ndërsa veçanërisht pensionistët të cilët mbesin në përcaktimin ta pushtojnë Sharrin nëpër të gjitha pjesët e tij, janë të mahnitur nga përcaktimi i seancës së Qeverisë, Mali Sharr dhe Malet e Osogovës të deklarohen si zona të mbrojtura. Sipas ministrit të mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Naser Nuredini, ajo do të thotë që jo vetëm që do të përmbushen qëllimet nacionale, strategjike dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës, por përfitime do të ketë edhe shteti, ndërsa veçanërisht interes do të ketë populli dhe komunitat të cilat do të përfshihen në zonat e mbrojtura. Ministri Nuredini ende është me mendimin që do të rriten mundësitë për bashkëpunim përtej kufirit me vendet fqinje, nga aspekti që Mali Sharr do të bëhet një prej parqeve më të mëdha në Evropë, ndërsa njëkohësisht do të thotë edhe mbrojtje të këtyre zonave, përparim dhe përmbushje të obligimeve ndaj Bashkimit Evropian. Shumë pensionistë jo vetëm nga rajoni i Te-



tovës, por edhe më gjerë me mahnitje e pranuan lajmin Mali Sharr të deklarohet si Park nacional. "Nuk mund ta paramendoj veten pa mal, pa Kodrën e Diellit dhe vende të tjera, pa majat e Luboteni dhe Majën e Titos dhe shumë të tjera, në të cilat ngjitem me këmbëngulje. Njëkohësisht, nuk ka revoltë më të madhe ndaj atij që sillet egërsisht ndaj bukurive natyrore" - tha pensionisti dhe alpinisti, Dime Gjoçevski.

Pensionisti Sali Raufi është me prejardhje është nga pjesa tjetër perëndimore e Malit Sharr, të cilën qeveritë kosovare veçse e kanë deklaruar për Park nacional. "Freskinë pensioniste e mbaj me ngjitjen time në Malin Sharr prej Kobilicës dhe vizitës së që ua bëj vatrave të mia tetovare. Përveç rekreacionit, kënaqem në atë që e përjetoj në mal. Më pengon

shumë kur hasi në pjesë ku janë prerë drunjtë, ku shkatërrohet gjithçka që është e bukur dhe atraktive. Më në fund, shpresoj që do t'i vijë fundi kësaj", thotë pensionisti Raufi.

Përveç se me pensionistët, për çështjen e deklarimit të Malit Sharr për Park nacional, biseduam edhe me të tjerë, dashmirës të vërtetë të malit. Pothuajse të gjithë në një frymë thonë që më në fund është mirë që shteti ka shfaqur interes dhe do të fitojmë rajon të mbrojtur, të cilin e meritojmë.

Nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor paralajmërojnë bisedime me popullatën lokale, me qëllim që të dëgjohet mendimi i tyre. Përndryshe, ky propozim bazon në mendimin e ekipit të ekspertëve pas studimit të përpiluar për valorizim të përmbajtjeve me nivel të lartë të

vlerave biologjike dhe kulturore. Përndryshe, Mali Sharr është i gjatë tetëdhjetë kilometra, i gjerë prej 10 deri 30 kilometra me rreth 1,600 kilometra katror dhe parqet rezervat natyror i cili dallohet me florë të pasur me mbi 2.000 lloje, prej të cilave 150 janë endemike. Është i pasur edhe me faunë, me lloje të rralla të ariut, rrëqebullit, dhisë së egër, ujçve dhe shumë të tjera. Në Malin Sharr ka 39 liqe malor, prej të cilave 25 janë të përhershme. Nëpër Sharr ka edhe mbi 20 maja, të cilat tejkalojnë 2.000 metra lartësi mbidetare, ndërsa dominuese janë Maja e Titos, Luboteni, Kobilica. Të shpallurit e Malit Sharr për Park nacional mbetet si kënaqësi dhe përjetim i mëtutjeshëm para se gjithash për pensionistët, të cilët janë vizitorë të shpeshtë të shpateve, luginave dhe majave të tij. (Gojko Eftoski)

SHPÇAIR

## Ndihmë për shkak të gjendjes me pandeminë

Në mbledhjen telefonike të Këshillit ekzekutiv pranë SHP Çair, e cila u mbajt më 6 maj, u soll vendim për ndarje të ndihmës të njëhershme në të holla, për shkak të gjendjes me koronavirusin, ndërsa në pajtim me kriteret e përcaktuara të KE. Përmes kontaktit telefonik me kryetarët e degëve, të cilat kanë evidencë për gjendjen e anëtarëve të tyre që iu duhet ndihmë, u përpilua listë për ndihmë të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes me Covid 19.

Të 21 anëtarëve të Shoqatës së pensionistëve Çair ju dha ndihmë të njëhershme nga 3000 denarë. Mjetet iu ndanë pensionistëve me pensione të ulëta, të sëmurë dhe jo në gjendje të mirë, ndërsa në familjet e tyre nuk realizohen të ardhura të tjera. Çdo mbështetje është e rëndësishme, veçanërisht anëtarëve me të ardhura më të ulëta, ose pensionistëve që kanë probleme me të rënda shëndetësore dhe ballafaqohen me furnizim të ilaçeve më të shtrenjta. Këshilli ekzekutiv në mbledhjen e njëjtë soll vendim për vazhdim me aksionin për ndarje të maskave mbrojtëse kualitative për shfrytëzim të shumëfish të, të cilat mund të sterilizohen me hekurosje. U ndanë edhe 40 maska mbrojtëse, prej të cilave 20 u ndanë për anëtarët e Aktivitetit të pensionistëve, të cilat do të sjellin në rritjen e shkallës së mbrojtjes së shëndetit të tyre. Me atë, Shoqata i merr dhe zbaton të gjitha masat në drejtim të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit të anëtarëve të saj. Përndryshe, këto aktivitete zbatohen dhe realizohen në kuadër të rekomandimeve dhe programit të shoqatës që i sollti Këshilli ekzekutiv i LSHPM, për shkak të gjendjes nga koronavirusi.

(Vasil Paçemski)

## SHP STRUGË

### Shënohet 75 vjetori i Ditës së fitores ndaj fashizmit

Për shkak të pandemisë, Dita e fitores ndaj fashizmit këtë vit në Strugë është shënuar në grupe. Në atë rast, më 9 maj të këtij viti në ora 10 delegacionet e Lidhjes së luftëtarëve nga Struga dhe rajoni i Strugës, vendosën lule të freskëta te Përmendorja e Revolucionit në sheshin e Strugës si dhe te bustet e luftëtarëve të rënë në Bregun e Drinit të Zi, në shenjë kujtimi

të kësaj dite. Në lirin e fituar me vështirësi të qytetarëve të Maqedonisë, jetën e kanë humbur më shumë se 24.000 luftëtarë, prej të cilëve 163 kanë qenë struganë. Kryetari i luftëtarëve, me disa fjalë të pranishmit i përkujtoi në Luftën e Dytë Botërore, duke theksuar: Të mbahet mend por të mos përsëritet. "Për shkak të pandemisë dhe gjendjes së jashtëzakonshme,

mbledhjet dhe fjalimet këtë vit u ndaluan, por nuk u harruan kujtimet për Ditën e fitores. Të mbahet mend, por të mos përsëritet", theksoi kryetari i DK të Lidhjes së luftëtarëve nga Lufta Nacionalçlirimtare e Maqedonisë, ndërsa tani mbështetës Ajredin Memeti. Edhe shumë pensionistë, nga dy ose vet u përkulën atyre që e dhanë jetën për një Maqedoni të lirë. (S.K)

## "DAUTI - KOMERC" NDIHMON PENSIONISTËT

Kompania e njohur Dauti-Komerc, me seli në Saraj, edhe kësaj radhe i ndihmon pensionistët nga kjo Komunë. Me rastin e Muajit të Shenjtë të Ramazanit si dhe pandemisë Covid 19, kompania në fjalë, përmes Fondacionit Albiz ku edhe është anëtare, Shoqatës së pensionistëve Saraj i dhuroi 150 pako me artikuj ushqimor. Me këtë rast, u

takua udhëheqësia e Shoqatës, Komisioni për shëndetësi dhe çështje sociale, si dhe kryetarët e degëve, të cilët e organizuan këtë ndihmë. Edhe krahas asaj që shoqata ka pasqyrë të statusit social të anëtarëve të saj, pas mbajtjes së takimeve edhe me Këshillat e degëve, u përpilua listë e re. Pastaj me një makinë transportuese, e cila gjitha-

shtu ishte pronë e kompanisë në fjalë, pakot u dorëzuan nëpër degë. Kjo ndihmë është e mirëseardhur dhe në kohë të duhur për pensionistët me të ardhura më të ulëta, si dhe për ata me shëndet të dobët, veçanërisht gjatë Muajit të Ramazanit. Shoqata konsideron që ndarja e pakove është realizuar në mënyrë më të mirë të mundshme



dhe kjo ndihmë ka shkuar në vend të duhur. Me këtë rast, Shoqata e pensionistëve Saraj, në emër të pensionistëve të cilët e morën këtë

ndihmë dhe në emër të të gjithë anëtarëve, i falënderohet Kompanisë Dauti-Komerc për këtë gjest human. (B.B)